VENDIM
Nr. 10, datë 21.1.2022

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "IRARBA ENERGJI" SHPK, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UNITED BANK OF ALBANIA) SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 63 prot., datë 13.1.2022, dhe relacionin nr. 63/1, datë 18.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë 'Irarba Energji' sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 225, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Banka of Albania sh.a.).

- Në nenin 10, pika 2, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 21.7.2016, parashikohet si vijon:

"2. Në rast se dokumentacioni nuk është dërguar konform nenit 7, por është marrë vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit, afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, do të fillojë nga dita e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të kërkuar nga ERE. Nëse pas marrjes së vendimit informacioni nuk dërgohet brenda 2 muajve, atëherë vendimi për fillimin e procedurave e humbet fuqinë juridike dhe i licencuari do të paraqesë një kërkesë të re në ERE.".

- ERE ka njoftuar shoqërinë, për fillimin e procedurave, për shqyrtimin e kërkesës së saj, për transferimin e aseteve, me shkresën e datës 10.12.2021. Duke marrë në konsideratë kohën që i nevojitet postës, përllogaritet që shoqëria të ketë marrë dijeni për vendimin më datë 12.12.2021.

- Referuar parashikimeve të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", afati dymujor përfundon më datë 12.2.2022.

- Duke qenë se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti nuk është e qartë natyra e marrëveshjes/marrëveshjeve me bankën mbi këtë transferim dhe me qëllim koordinimin e listës së aseteve që do të transferohen, duke marrë në konsideratë të gjitha afatet që nevojiten për vendosjen e komunikimit me shoqërinë apo zhvillimit të një seance dëgjimore, për të sqaruar këtë dokumentacion, afatin për të njoftuar shoqërinë për seancën, afatin që i nevojitet shoqërisë për të plotësuar sa kërkuar, afatin për të shqyrtuar dokumentacionin që mund të depozitojë shoqëria, periudhën kohore që i nevojitet Bordit të ERE-s për të shqyrtuar praktikën e më pas të shprehet, në mbështetje të nenit 67, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., me 30 (tridhjetë) ditë pune, duke filluar ky afat nga data 12.2.2022.

- Brenda këtij afati do të saktësohet/qartësohet dokumentacioni me shoqërinë "Irarba Energji" sh.p.k., nëpërmjet zhvillimit të një seance të mundshme dëgjimore ose komunikimit shkresor nëse do të jetë e nevojshme në vijim të seancës dëgjimore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Banka of Albania) sh.a., duke filluar ky afat nga data 12.2.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti